



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 1382/Prot.
11

Tiranë, më 3. 3. 2021

UDHËZIM

Nr. 5, datë 3. 3. 2021

PËR

DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 30.3.2020 "PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE PËRBËRËS, FORMËN E DIPLOMËS OSE CERTIFIKATËS TË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE PROCEDURËS SË REGJISTRIMIT TË TYRE NË REGJISTRIN SHTETËROR TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR"

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 10 dhe 91, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 30.3.2020, bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja "m", e pikës 1, të Kreut II, riformulohet si vijon:

"m) Numri i matrikullimit të ciklit paraardhës të studimeve në diplomat e ciklit të dytë dhe të tretë/ Numri i regjistrimit që gjendet në vërtetimin e njësimit të diplomës, për diplomat që janë lëshuar jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe ID e Maturës Shtetërore/ Numri i dokumentit të njëvlershmërisë së dëftesës/diplomës së arsimit të mesëm të lartë që është lëshuar jashtë Republikës së Shqipërisë (numri i regjistrimit veçantë për studentët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë para vitit 2006) në diplomat "Bachelor", diplomat ose certifikatat profesionale dhe diplomat "Master i shkencave" të programeve të integruara të studimeve;"

b) Shkronja "n", e pikës 1, të Kreut II, riformulohet si vijon:

“n) Numri i diplomës së studimeve universitare të përfunduara më parë për diplomat e ciklit të dytë dhe të tretë/Numri i regjistrit që gjendet në vërtetimin e njësimit të diplomës;”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Evis KUSHI

